



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:100745

Datë: 07.05.2024

Numri i dokumentit: 05656688

P.nr.202/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me bashkëpunëtorin profesional Samir Morina, në lëndën penale kundër të akuzuarit I. M. nga fshati A., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par 1.4 të KPRK-së, i akuzuar nga Prokuroria Themelore - Departamenti i përgjithshëm me aktakuzë PP/II.nr.775/2021, të datës 08.02.2023, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 22.01.2024, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Kastriot Memaj dhe të akuzuarit I. M., **më 25 janar 2024, nxjerri dhe publikisht shpalli këtë:**

A K T G J Y K I M

I akuzuari **I. M.** nga i ati B., e ëma H., e vajzërisë H., i lindur më ..., nga fshati A., Komuna e Malishevës, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, më parë i pa dënuar, i martuar, ka të kryer katër (4) vite të shkollës fillore, pensionist, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

SEPSE,

Më datën 25.05.2021, rreth orës 09:00/h në Malishevë i pandehuri I. M., me dashje dhe me mjet të rrezikshëm (b.), me të cilin mund të shkaktoj lëndim të lehtë trupor, i shkakton lëndime të lehta trupore, të dëmtuarit B. M., në atë mënyrë që në ditën kritike pas një mosmarrëveshje të mëhershme, i pandehuri I. nga gjepi nxjerr një brisk të kuq dhe derisa i dëmtuari-pandehuri B. tenton të ia hejë briskun nga dora, i pandehuri me të e godet të dëmtuarin në dorën e majtë dhe në shpinë, me çka tek i dëmtuari ka shkakuar plagë prerëse në gishtin e madh të dorës së djathtë dhe gërvishtje sipërfaqësore të lëkurës në bërrylin e majtë dhe në shpinë që si të tilla bëjnë pjesë në lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, të përshkruara në akt ekspertizën mjeko-ligjore të Dr. B. C. të dt. 18.06.2021.

- me çka ka kryer veprën lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par 1.4 të KPRK-së.

Gjykata konform nenit 4,6,7,17,38,39,40,42,43,69,70,185 par.2 lidhur me par.1 nën par 1.4 të KPRK-së, si dhe nenit 241,242,364,365,449 par. 1 dhe 2, nën par. 2.1 dhe 2.6 të Kodit të Procedurës Penale, të njëjtin e gjykon me:

DËNIMIN ME KUSHT

Ashtu që të akuzuarin **I.M.** e dënon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej një (1) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

KONFISKOHET B. i xh. me ngjyre te kuqe nr. ..., si objekt i kryerjes së kësaj vepre penale.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumën prej 20,00 €, për shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 30,00 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Gjakovë, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzë PP/II.nr. 775/2021, të datës 08.02.2023, kundër të akuzuarve: B. M. nga fshati A., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe I. M. nga fshati A., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë truporë nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par 1.4 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar më 22.01.2024, pas përshkrimit të rastit nga gjykata se i akuzuari B. M. sipas flet kthesës konstatojnë se i njëjti është shpërngulur nga fshati dhe këtë deklaram e kanë dhënë vëllezërit e tij. Gjykata ka bërë veçimin e lëndës për të akuzuarin B. M., pasi që për këtë janë pajtuar: Prokurori i shtetit Kastriot Memaj, i akuzuari I.M., i akuzuari ka kërkuar që të bëhet veçimi i procedurës penale me arsyetimin se jam i moshës së vjetër dhe nuk kam mundësi shpesh që të vij në gjykatë pasi ka probleme shëndetësore, gjykata gjeti se në këtë çështje penale duhet të veçohet procedura penale për të akuzuarin B.M., për të cilin do të zhvillohet procedura penale e veçantë pasi që të bëhet sigurimi i prezencës së tij nga gjykata, e cila lëndë e ka marrë numrin e ri sipas regjistrimit të gjykatës. Lënda për të pandehurin B. M. evidentohet nën numrin P. nr. 23/2024.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar për të pandehurin I. M. më 22.01.2024, pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit Kastriot Memaj, të pandehurit iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

Pas deklaramit të pandehurit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë.

Prokurori i shtetit jep mendimin se: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, gjatë këtij shqyrtimi fillestar pasi që pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare prandaj gjykatës i propozoj që të bëj pranimin e fajësisë si shprehje të lirë të vullnetit dhe të akuzuarit t'i shqipton një dënim meritor konform ligjit, duke i vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, në pajtim me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe njëherë të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale.

I pandehuri I.M., deklarohej i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohem të njëjtën e pranoj në mënyrë vullnetare, nga dita e veprës penale nuk kemi pasur probleme, kërkoj nga gjykata që të më dënoj sa më pak pasi që jam pensionist i gjendjes jo të mirë ekonomike.

Nga thëniet e vet të pandehurit në shqyrtimin fillestar u vërtetua se ai me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: raporti fillestar i incidentit nr. ... i datës 25.05.2021; raporti i policit F.B.ID#... i datës 25.05.2021; procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin B.M. dhënë në Stacionin Policor në Malishevë më 25.05.2021; procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin I. M. dhënë në Stacionin Policor në Malishevë më 25.05.2021; raporti mjekësor Q.K.M.F në Malishevë, për të pandehurin B. M., nr. protokollit ... i datës 25.05.2021; raporti mjekësor i Spitalit Regjional në Prizren, për të pandehurin B. M., nr. protokollit ... i datës 25.05.2021; raporti mjekësor QKUK-së në Prishtinë, për të pandehurin I. M., nr. protokollit ... i datës 25.05.2021; vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve-briskut të xhepit; Akt ekspertiza mjeko-ligjore e Dr. B. C.e datës 18.06.2021; raporti mbi gjendjen e shëndetit mendor i të pandehurit B. M., lëshuar nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike më 27.09.2022; CD me video incizim nga vendi i ngjarjes dhe foto dokumentacioni, si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Gjykata me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës. Gjykata ka pranuar deklarin e pranimin të fajësisë nga i pandehuri dhe vlerëson se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që ka kryer i pandehuri, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarin e pranimin të fajësisë nga i pandehuri e ka pranuar si të tillë.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që posaçërisht rrethanë lehtësuese ka marr faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, të njëjtën e ka pranuar në mënyrë vullnetare, i premtonte gjykatës se nuk do të përsëris vepër tjetër penale, është i gjendjes së dobët ekonomike, është pensionist, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti, të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata t'i zbatoi dispozitat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimit të parapara me nenin 70 të KPRK-së, gjykata ka ardhur në përfundim se i akuzuari ka kryer veprën penale të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, të akuzuarin e dënon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej një (1) viti nuk kryen ndonjë

vepër tjetër penale, me bindjen se me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, dhe ky dënim i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Bazuar në nenin 92 të KPRK-së, nenit 270,271,276 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të aktgjyimit për konfiskimin e Briskut të xhepit me ngjyre te kuqe.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marr bazuar në nenin 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.1 dhe 2.6 të KPP-së, si dhe bazuar në nenin 36 par. 3 nën par. 3. 1 te Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit nr.08/L-109.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 364,365 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P.nr. 202/23, më 25 janar 2024

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Njazi MORINA

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.